

## Termet e Referencës

“Angazhimi i një eksperti/e për vlerësimin e kapaciteteve organizative dhe hartimin e planit të zhvillimit organizativ të HANDIKOS”

### I. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983.

Si organizatë përfaqëson, përkrah dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barazinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara

### II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Advancing Rights and Participation of Children with Disabilities in Kosovo”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Projekti përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të monitoruar të drejtat e tyre dhe për të ndikuar në vendimmarrje në nivel lokal.

Në kuadër të përpjekjeve për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe organizative të HANDIKOS, është paraparë realizimi i një **Vlerësimi të Kapaciteteve Organizative (Organizational Capacity Assessment – OCA)**.

Vlerësimi do të shërbejë si bazë për identifikimin e kapaciteteve ekzistuese, praktikave të mira, sfidave dhe boshllëqeve në fusha të ndryshme të funksionimit të organizatës.

Procesi do të mundësojë që HANDIKOS të identifikojë në mënyrë pjesëmarrëse fushat prioritare për zhvillim dhe, mbi këtë bazë, të hartojë një **Plan të Zhvillimit Organizativ (Organizational Capacity Development – OCD)** për periudhën e ardhshme.

Vlerësimi do të zhvillohet përmes një procesi pjesëmarrës, ku do të përfshihen përfaqësues të ndryshëm të organizatës, me qëllim që rezultatet të pasqyrojnë sa më mirë gjendjen reale, nevojat dhe prioritetet e HANDIKOS.

### III. OBJEKTIVA E DETYRËS

Objektivi i përgjithshëm i angazhimit është realizimi i një Vlerësimi të Kapaciteteve Organizative të HANDIKOS dhe mbështetja në hartimin e një Plani të Zhvillimit Organizativ, bazuar në gjetjet dhe nevojat e identifikuara gjatë procesit të vlerësimit.

Eksperti/ja do të udhëheqë një proces pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës, i cili do të mundësojë:

- a) vlerësimin e kapaciteteve aktuale të HANDIKOS në fusha relevante të zhvillimit dhe funksionimit organizativ;
- b) identifikimin e pikave të forta, sfidave, boshllëqeve dhe nevojave për zhvillim;
- c) prioritizimin e fushave që kërkojnë ndërhyrje dhe përmirësim;
- d) dokumentimin e gjetjeve dhe përgatitjen e një raporti të Vlerësimit të Kapaciteteve Organizative;
- e) mbështetjen e HANDIKOS në zhvillimin e një Plani të Zhvillimit Organizativ, duke përcaktuar prioritetet, objektivat, veprimet, përgjegjësitë dhe afatet kohore.

Në kuadër të këtij procesi, HANDIKOS ka paraparë organizimin e një punëtorie pjesëmarrëse me stafin dhe përfaqësuesit relevantë të organizatës, e cila do të shërbejë si komponenti kryesor i procesit të rivlerësimit të kapaciteteve organizative.

Punëtorja do të mundësojë diskutimin e përbashkët mbi gjendjen aktuale të organizatës, identifikimin e ndryshimeve dhe progresit që nga vlerësimi i vitit 2023, si dhe përcaktimin e fushave prioritare për zhvillim.

#### **IV. KUALIFIKIMI**

Eksperti/ja i/e angazhuar për realizimin e këtij aktiviteti duhet të plotësojë këto kritere:

- përvojë profesionale në zhvillimin e kapaciteteve organizative të organizatave të shoqërisë civile;
- njohuri të mira mbi qeverisjen dhe menaxhimin e organizatave të shoqërisë civile;
- njohuri dhe përvojë në zhvillimin e politikave dhe procedurave organizative;
- përvojë në planifikim strategjik dhe zhvillim organizativ;
- përvojë në facilitimin e punëtorive pjesëmarrëse;
- aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe ndërpersonale;
- diplomë universitare në shkenca sociale, administrim publik, shkenca politike, menaxhim ose fusha të ngjashme;
- përvojë në sektorin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara përbën përparësi.

#### **V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË**

Eksperti/ja do të jetë përgjegjës për:

- shqyrtimin dhe përshtatjen e mjetit të Vlerësimit të Kapaciteteve Organizative;
- zhvillimin e metodologjisë dhe agjendës së punëtorisë në konsultim me HANDIKOS;
- mbajtjen e takimeve fillestare dhe konsultative me përfaqësuesit e HANDIKOS;
- shqyrtimin e dokumenteve dhe politikave relevante të organizatës;
- facilitimin e punëtorisë pjesëmarrëse 3 ditore;
- udhëheqjen e diskutimeve në grupe dhe dokumentimin e diskutimeve, vlerësimeve, gjetjeve dhe rekomandimeve;
- plotësimin/finalizimin e mjetit OCA dhe përgatitjen e raportit të Vlerësimit të Kapaciteteve Organizative;

- prezantimin e gjetjeve para HANDIKOS dhe integrimin e komenteve e validimin e raportit final;
- facilitimin e procesit për hartimin e Planit të Zhvillimit Organizativ;
- përcaktimin e prioriteteve, objektivave, aktiviteteve, përgjegjësi dhe afateve në Planin OCD.

## VI. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Tetor/Nëntor 2026 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

| Detyra                                                                                                              | Kohëzgjatja |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| Përgatitja e metodologjisë, agjendës dhe materialeve të nevojshme për realizimin e OCA gjatë punëtorisë me HANDIKOS | 1ditë       |
| Fasilitimi i punëtorisë                                                                                             | 3 ditë      |
| Analiza e gjetjeve dhe hartimi i Planit të Zhvillimit Organizativ                                                   | 3 ditë      |
| TOTALI                                                                                                              | 7 ditë      |

## VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa do të bëhet pas përfundimit të aktivitetit dhe dorëzimit të raportit final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizojë pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

## VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim;
- Curriculum Vitae (CV);
- Propozimi financiar.

Aplikimet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: [nora.simitciu@handi-kos.org](mailto:nora.simitciu@handi-kos.org). Ju lutem, shkruani në subjekt **Aplikim – Ekspert për Vlerësimin e Kapaciteteve Organizative dhe Planin OCD**.

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është 5 Tetor.**

**Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!**

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetime.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve** si dhe **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.